



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.12.2022

**MBLEDHJA Nr. 60,**  
**Datë 19.12.2022, ora 11:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e hënë, datë 19.12.2022, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 60 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 14.12.2022
2. Mbi licencimin e shoqërisë “H&E Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
3. Mbi licencimin e shoqërisë “Bigwind” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “Ateani Energy” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Shutri 1” me kapacitet të instaluar 370 kW dhe “Shutri 2” me kapacitet 1600 kW, me kapacitet total të instaluar 1970 kW
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “Ateani Energy” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
6. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 24.05.2022 “Mbi kërkesën e shoqërisë “Irarba Energji” sh.p.k. për transferimin e asetëve të paluajtshme në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a.”
7. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ANËTARE E BORDIT**  
**Erjola SADUSHI**